



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 160

Tiranë – E enjte, 25 gusht 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr. 10, datë 2.6.2016	Për masat për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2016..... 19971
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr. 12, datë 14.7.2016	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 9, datë 30.5.2016, “Për procedurat e konkurrimit, miratimit, porositjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore digjitale, në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar që kanë laboratorë me tableta për integrimin e platformës <i>e-learning</i> ”..... 19973
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr. 14, datë 28.7.2016	Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë..... 19973
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 131, datë 15.8.2016	Mbi ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH sh.a. “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”..... 19977
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 132, datë 15.8.2016	Mbi shqyrtimin e propozimeve për disa shtesa dhe ndryshime në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë midis OSHEE-së dhe PPE-së, të miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016..... 19977
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 133, datë 15.8.2016	Për miratimin e planit të investimeve për vitin 2016 për shoqërinë “KESH” sh.a..... 19979
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 134, datë 15.8.2016	Për miratimin e planit të investimeve për vitin 2016 për shoqërinë “OST” sh.a..... 19984
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 135, datë 15.8.2016	Për miratimin e planit të investimeve për vitin 2016 për shoqërinë “OSHEE” sh.a..... 19986

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 136, datë 15.8.2016	Mbi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a., për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 111, datë 1.7.2016, “Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, të Bordit të ERE-s, për periudhën 1 korrik 2016 – 31 dhjetor 2016.....	19994
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 137, datë 15.8.2016	Mbi kërkesën e OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit për periudhën e mbetur të vitit 2016.....	19994

**UDHËZIM****Nr. 10, datë 2.6.2016****PËR MASAT PËR ZHVILLIMIN E
PROVIMEVE TË MATURËS
SHTETËRORE 2016**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit Ministrave nr. 78, datë 8.2.2006, “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”,

UDHËZOJ:**KREU I****PROVIMET E DETYRUARA DHE ME
ZGJEDHJE TË MATURËS SHTETËRORE
2016**

1. Për provimet e Maturës Shtetërore ndiqen procedurat e përcaktuara në “Rregulloren e Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë” miratuar me urdhrin nr. 91, datë 2.3.2016, të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

2. Periudhat kohore të ekspozimit potencial të sekretit (KOEPS) për Maturën Shtetërore 2016, të jenë:

- a) 30 maj – 4 qershor 2016;
- b) 5–11 qershor 2016;
- c) 12–17 qershor 2016;
- d) 18–24 qershor 2016.

3. Të drejtën e përzgjedhjes së rastësishme të testit përfundimtar për çdo lëndë, e kanë përzgjedhësit e testit përfundimtar (PTP), të ngarkuar me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe specialisti përkatës i përcaktuar në urdhrin e drejtorit të AKP-së dhe me procesverbal.

4. Lista e punonjësve të AKP-së, të cilët përfshihen në KOEPS për secilën periudhë të përmendur në pikën 2 të këtij udhëzimi, miratohet nga drejtori i përgjithshëm i AKP-së.

5. Specialistët e lëndëve përkatëse të AKP-së kanë për detyrë të hartojnë, së bashku me PTP, skemat e vlerësimit të testeve dhe ndihmojnë më tej në proceset e formatimit, shumëfishimit dhe shpërndarjes së tyre.

6. Pas zhvillimit të çdo provimi, testet të dërgohen nga shërbimi postar në masa sigurie në godinën e shkollës 9-vjeçare “Sabaudin Gabrani”, Tiranë. AKP-ja kryen inventarizimin dhe shpërndarjen e tyre në qendrat e vlerësimit.

7. Vlerësimi i testeve do të bëhet në qendrat e mëposhtme:

- a) Në Tiranë, në godinën e shkollës “Sabaudin Gabrani”, qendra nr. 1;
- b) Në Tiranë, në godinën e shkollës “Sabaudin Gabrani”, qendra nr. 2;
- c) Në Elbasan, në godinën e shkollës “Vasil Kamami”;
- d) Në Shkodër, në godinën e shkollës “Jordan Misja”;
- e) Në Fier, në godinën e shkollës “Naim Frashëri”;
- f) Në Korçë, në godinën e shkollës “Sevasti Qiriazhi”.

8. Drejtoritë arsimore rajonale Tiranë, Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë, të marrin masa për lirim të mjediseve për vlerësimin e testeve në godinat e sipërpërmendura, të cilat do të ruhen me shërbim 24 orësh nga Policia e Shtetit, gjatë periudhës 5–30 qershor 2016.

9. Transporti i testeve nga Tirana për në secilën nga qendrat e vlerësimit Elbasan, Shkodër, Fier, Korçë dhe anasjellas, të bëhet me automjetet e DAR-së përkatëse dhe nga grupi monitorues, të përmendur në pikën 16 të këtij udhëzimi, nën masa të rrepta sigurie.

KREU II**MONITORIMI I PROCESIT TË
PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE
2016**

10. DAR/ZA-të, të marrin të gjitha masat për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e aparaturave të bllokimit/zhurimit të mjeteve të komunikimit elektronik dhe përdorimit të detektorëve.

a) Një grup i ngritur me urdhër të drejtuesit të DAR/ZA-së përkatëse vendos këto aparatura në vende që sigurojnë bllokimin/zhurimin e valëve të mjeteve të komunikimit elektronik në çdo mjedis të provimit.

b) Çdo DAR/ZA trajnon përgjegjësit e administrimit të provimeve (PAP) dhe përgjegjësit e kateve (PK) për përdorimin efektiv të detektorëve për çdo qendër provimi.



c) Kontrolli me detektor ushtrohet mbi maturantët/kandidatët dhe të gjithë personat që merren me administrimin e provimit.

11. Përgjegjësi i sektorit të IT-së në çdo DAR/ZA përgjigjet për mirëfunksionimin e aparaturave të bllokimit/zhurimit të mjeteve të komunikimit elektronik dhe përdorimit të detektorëve.

12. PAP-i dhe përfaqësuesit e MAS-it në ditën e provimit, kujdesen në mënyrë të vazhdueshme që detektorët dhe aparaturat e bllokimit/zhurimit të jenë në gjendje pune.

13. Çdo neglizhencë ndaj detyrimit për mirëfunksionimin e aparaturave të bllokimit/zhurimit ngarkon me përgjegjësi administrative dhe përgjegjësi të parashikuara nga Kodi Penal, drejtuesit dhe specialistët e IT-së në DAR/ZA, PAP dhe PK.

14. Drejtuesit e DAR/ZA-ve dërgojnë zyrtarisht, një ditë përpara çdo provimi, listën dhe vendndodhjen e qendrave të provimit të drejtuesit rajonalë të CEZ Shpërndarje, në mënyrë që të merren masat e nevojshme për furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike të këtyre qendrave.

KREU III

MONITORIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË MATURËS SHTETËRORE 2016

15. Pas çdo provimi, në secilën nga qendrat e vlerësimit të funksionojë në mënyrë të vazhdueshme një grup i administrimit dhe i monitorimit të procesit të vlerësimit të testeve me përbërje si më poshtë:

- a) një përfaqësues i AKP-së;
- b) një përfaqësues DAPU-së në MAS;
- c) një përfaqësues i DAR-së përkatëse.

16. Grupi monitorues në qendrën e vlerësimit ka detyrat si vijon:

a) Përgjigjet për tërheqjen e testeve nga AKP-ja dhe për transportin e tyre drejt qendrës së vlerësimit;

b) Merr në dorëzim testet, me procesverbal që nënshkruhet nga tre përfaqësuesit e grupit monitorues, si dhe nga personi i sektorit të administrimit të testeve në AKP, i cili bën dorëzimin e tyre;

c) Kontrollon nëse është siguruar ruajtja nga policia e objektit ku do të zhvillohet procesi i vlerësimit të testeve;

Faqe | 19972

d) Qëndron në mjediset e qendrës së vlerësimit gjatë procesit të vlerësimit dhe raporton në institucionet përkatëse.

17. Personat që bëjnë pjesë në grupet e monitorimit të procesit të vlerësimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2016 për secilën qendër vlerësimi, caktohen nga ministri i Arsimit dhe Sportit.

18. Periudha e monitorimit dhe grafiku i paraqitjes së përfaqësuesve të grupit monitorues në AKP është:

- a) Për lëndën “Gjuhë e huaj”:
5–11 qershor 2016;
- b) Për lëndën “Gjuhë dhe letërsi shqipe”:
12–18 qershor 2016;
- c) Për lëndën “Matematikë”:
18–24 qershor 2016;
- d) Për lëndët me zgjedhje:
24–30 qershor 2016.

19. Për drejtimin dhe mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit, AKP-ja të caktojë në çdo qendër dhe për secilin provim dy specialistë, të cilët do të përzgjidhen dhe trajnohen prej saj.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

20. Punonjësit që angazhohen jashtë kohës normale të punës në procesin e administrimit dhe vlerësimit të testeve të Maturës Shtetërore 2016, të paguhën sipas akteve nënligjore në fuqi.

21. Shpenzimet e udhëtimit, hotelit dhe ushqimit të specialistëve të përfshirë në proces mbulohen nga institucionet përkatëse.

22. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Drejtoria e Financës, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

**UDHËZIM**

Nr. 12, datë 14.7.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 9, DATË 30.5.2016, “PËR
PROCEDURAT E KONKURRIMIT,
MIRATIMIT, POROSITJES,
SHPËRNDARJES DHE SHITJES SË
TEKSTEVE SHKOLLORE DIGJITALE,
NË INSTITUCIONET ARSIMORE TË
SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR
QË KANË LABORATORË ME TABLETA
PËR INTEGRIMIN E PLATFORMËS
E-LEARNING”**

Në mbështetje të neneve 2 dhe 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të vendimit nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollorë të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Fjalja e fundit e pikës 1, të kreut 1, të udhëzimit nr. 9, datë 30.5.2016, shfuqizohet.
2. Dy fjalitë e fundit të pikës 1, të kreut III, të udhëzimit nr. 9, datë 30.5.2016, shfuqizohen.
3. Pika 17/a, e kreut III, ndryshon si vijon:
 - a) Librin shkollor për lëndën përkatëse.
4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Shkollore Digjitale në MAS, DAR/ZA, ISHA dhe institucionet shkollorë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla**

UDHËZIM

Nr. 14, datë 28.7.2016

**PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE NË
ARSIMIN E MESEM TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, pika 2, germa “a”, dhe nenit 48, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi i vlerësimit të nxënësit

Qëllimi kryesor i vlerësimit është gjykimi mbi arritjet e nxënësit referuar filozofisë dhe përmbajtjes së kurrikulës bazuar në kompetenca, si dhe të mbështesë të nxënët dhe përparimin e nxënësit. Ky qëllim përmbushet nga kombinimi i vlerësimit për të nxënë dhe i vlerësimit të të nxënët, bazuar në kornizën e vlerësimit të nxënësit në arsimin parauniversitar miratuar në datën 23.7.2015, nga ministri i Arsimit dhe Sportit.

Neni 2

Vlerësimi për të nxënë i nxënësit

Vlerësimi për të nxënë i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- 2.1 Vlerësimit të vazhduar (sipas shënimeve në evidencat e mësuesit);
- 2.2 Vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse;
- 2.3 Vlerësimit të portofolit lëndor të nxënësit.

Neni 3

Vlerësimi i vazhduar

1. Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësve në të gjitha aspektet e të nxënët, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.

2. Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.

3. Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënët, mësuesi mban shënime në evidencë për çdo nxënë. Shënimet në evidencë mund të mbahen me notë, simbole, komente etj., referuar niveleve të arritjes. Këto shënime përdoren nga mësuesit për të argumentuar vlerësimet e kryera përgjatë tremujorit. Në lidhje me këto vlerësime, mësuesi duhet:

- të konsiderojë dhe të paraqesë rezultatet e të nxënët për të cilat nxënësit janë duke punuar;
- të japin shembuj që ilustrojnë rezultatet e pritshme;
- të përcaktojnë kriteret e suksesit përmes diskutimeve ndërmjet tyre dhe me nxënësit;



- të krijojnë mundësi që nxënësit të demonstrojnë njohuritë, të kuptuarin, aftësitë dhe qëndrimet e tyre.

4. Mësuesi duhet të marrë në konsideratë balancën ndërmjet njohurive, shkathhtësive, qëndrimeve, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënësve në programin lëndor.

5. Mësuesi mund të përshtatë formatin e evidencës (shtojca 1), në varësi të specifikave të lëndës ose të krijojë një formë tjetër të mbajtjes së shënimeve, duke ruajtur pjesën përmbajtësore të saj.

Neni 4

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësve për një grup të caktuar rezultatesh të nxënësve, në përfundim të tremujorit. Ky vlerësim e orienton mësuesin për të përmirësuar mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve.

Neni 5

Vlerësimi me portofol lëndor

1. Vlerësimi i nxënësve bazuar në portofol lëndor, bëhet në përfundim të çdo tremujori dhe ka për qëllim vlerësimin e nxënësve në një kontekst të gjerë, duke përfshirë dokumentimin e kontributeve dhe arritjeve të tij për lëndën, për kompetencat kyçe, për punën individuale dhe në grup, krijimtarinë, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësve për veten dhe të tjerët.

2. Rubrikat e portofolit të nxënësve përcaktohen nga mësuesi referuar specifikave të lëndës. Rubrikat e portofolit mund të grupojnë:

- punë dhe detyra të kryera në klasë dhe jashtë saj;
- projekte individuale ose në grup;
- detyra dhe kontribute të pavarura të nxënësve, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.);
- vetëvlerësimet e nxënësve për arritjet e tij;
- reflektime të prindit/ nxënësve të tjerë ndaj ecures dhe arritjeve të nxënësve.

Neni 6

Vlerësimi i të nxënësve të nxënësve

Vlerësimi i të nxënësve të nxënësve kryhet nëpërmjet:

- vlerësimin periodik;
- vlerësimin përfundimtar.

Neni 7

Vlerësimi periodik

1. Vlerësimi periodik, kryhet në fund të një periudhe tremujore, për të evidentuar përparimin dhe arritjet e nxënësve, me qëllim monitorimin dhe raportimin e tyre.

2. Vlerësimi periodik tremujor jepet nëpërmjet 3 (tri) notave të veçanta, për:

- vlerësimin e vazhdueshëm me notë, që bazohet në shënime të mësuesit të mbajtura në evidencat për periudhën tremujore, duke gjykuar në mënyrë progresive;
- vlerësimin me notë nëpërmjet testit ose detyrës përmbledhëse në përfundim të periudhës tremujore;
- vlerësimin me notë të portofolit të nxënësve, për periudhën tremujore.

3. Këto tri vlerësime me notë shënohen në regjistrin në kolonat përkatëse në përfundim të çdo tremujori.

Neni 8

Vlerësimi përfundimtar

1. Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë dhe përshkrim referuar niveleve të arritjes.

2. Nota përfundimtare vjetore përmbledh notat vjetore si më poshtë:

- notën vjetore të vlerësimin të vazhdueshëm për tri periudha tremujore;
- notën vjetore të vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse për tri periudha tremujore;
- notën vjetore të vlerësimin të portofolit të nxënësve për tri periudha tremujore.

3. Peshat në përqindje sipas vlerësimeve:

Pesha në përqindje

Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i portofolit të nxënësve	20%



4. Hapat për njehsimin e notës përfundimtare vjetore, janë:

- përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhdueshëm (NVV), bazuar në tri notat tremujore, duke gjykuar në mënyrë progresive;

- përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmblledhëse (NTP) bazuar në tri notat tremujore, duke gjykuar në mënyrë progresive;

- përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NVP) bazuar në tri notat tremujore, duke gjykuar në mënyrë progresive;

- shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse;

- mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh. 8,8 ≈ 9);

- formula: Nota përfundimtare = (NVV x 0.4) + (NTP x 0.4) + (NVP x 0.2).

5. Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të fushës/lëndës.

Neni 9

Raportimi i arritjeve dhe i përparimit të nxënësve

1. Raportimi i arritjeve të të nxënësit bëhet nga mësuesi një herë në tre muaj dhe i jepet me shkrim prindit.

2. Raportimi i arritjeve dhe përparimit të nxënësve ka dy qëllime kryesore:

- së pari, siguron informacion të plotë dhe të vazhdueshëm rreth të nxënësit të nxënësve dhe përparimit të tyre, duke shërbyer si bazë për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të të nxënësit;

- së dyti, krijon një platformë, e cila u shërben mësuesve dhe prindërve të mbështesin nxënësit në hapat e mëtejshëm të të nxënësit, si dhe vetë nxënësve të zhvillohen në këtë proces.

3. Raportimi i arritjeve dhe i përparimit të nxënësve bazohet në evidencat e vlerësimit të vazhdueshëm, testet/detyrat përmblledhëse, si dhe portofolin e nxënësit.

Neni 10

Dispozita të fundit

1. Evidencat e vlerësimit të vazhdueshëm dorëzohen në përfundim të tremujorit në drejtorinë e shkollës, ku ruhen deri në përfundim të vitit shkollor.

2. Testet/detyrat përmblledhëse dhe portofoli i nxënësit janë objekt monitorimi deri në fund të vitit shkollor.

3. Ky udhëzim fillon zbatimin me klasën e 10-të arsimit të mesëm të lartë, viti shkollor 2016–2017.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në MAS, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Agjencia Kombëtare e Provimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, DAR/ZA-të dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

EVIDENCA TREMUJORE PËR MBATJEN E VLERËSIMEVE TË NXËNËSVE

ΠΡΟΙΟΝ 1

KLASA X

TREMUIJORI.

Muajt/Datat:

emuri

Komente

[illegible]

Shënim: Ky format llogaritet në A3, për shkak se numri i nxënësve është më i madh. Një lëndë mund të ketë një ose dy fletë (nga të dyja faqet). Në varësi të lëndës mund të llogaritet edhe numri i vlerësimeve. Kalona e komenteve në faqe A3 duhet të jetë më e gjatë.

**VENDIM****Nr. 131, datë 15.8.2016****MBI NDËRPRERJEN E PROCEDURËS SË SHPALLUR NGA SHOQËRIA KESH SHA “FTESË PËR SHPREHJE INTERESI PËR MARRËVESHJEN KUADËR PËR DEPOZITIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH sh.a. “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Në faqen zyrtare të KESH sh.a., është publikuar ftesa për shprehje interesi për “Marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”.

- Subjektet GEN-I Tërana sh.p.k., AXPO Trading AG dhe AAES kanë dërguar ankimet e tyre në ERE, me shkresat respektive nr. 490/4 prot., datë 8.7.2016, nr. 490/8 prot., datë 26.7.2016 dhe nr. 13 prot., datë 29.6.2016.

- KESH sh.a., në datën 20.7.2016, nëpërmjet shkresës nr. 5960/1 prot., i ka bërë me dije subjekteve si më sipër se: “Ky produkt i prezantuar nga KESH sh.a. nuk është subjekt i rregullimit nga “Rregullat e shitjes, blerjes dhe shkëmbimit të energjisë elektrike”, të miratuar nga ERE. KESH sh.a. funksionon si një shoqëri tregtare me kapital 100% shtetëror bazuar në përcaktimet e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

- I licencuari KESH sh.a., është një person juridik i pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 25.3.2009, i cili zbaton legjislacionin në fuqi, përfshirë dhe detyrimet e shërbimit publik, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe ushtron aktivitet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Është konstatuar se KESH sh.a. nuk ka respektuar dispozitat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i cili parashikon si

transaksione të energjisë elektrike, blerjen, shitjen dhe shkëmbimin.

- KESH sh.a. nuk ka respektuar parashikimet e “Rregullave dhe procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 100, datë 27.12.2006.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. KESH sh.a. të ndërpresë menjëherë çdo veprim të mëtejshëm për finalizimin e procedurës së shpallur “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”.

2. KESH sh.a. të publikojë në faqen e tij zyrtare të internetit, njoftimin për ndërprerjen e procedurës ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a., Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 132, datë 15.8.2016****MBI SHQYRTIMIN E PROPOZIMEVE PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË MODELIN E KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË MIDIS OSHEE-së DHE PPE-së, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 101, DATË 23.6.2016**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe neneve 3, germa “d”, dhe 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.8.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, në lidhje me propozimet për disa shtesa dhe ndryshime në modelin e kontratës së



shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016,

konstatoi se:

- Subjektet juridike Lengarica & Energy sh.p.k., shoqata AREA, Truen sh.p.k., Wenerg sh.a., Ballkan Green Energy sh.p.k., Albanian Green Energy sh.p.k., Energy Partners AL sh.p.k., Energy Plus sh.p.k., Kisi Bio sh.p.k., Gjo Spa Power dhe Erdat Lura sh.p.k., kanë paraqitur në ERE kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 23.6.2016.

- Pas fillimit të procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e shitblerjes së energjisë, miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016, të Bordit, ERE do të konsultohet me të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

- Përgjatë fazës së konsultimeve, të gjitha palët e interesuara do të njihen me propozimet e subjekteve më sipër e të shprehin qëndrimin e tyre në lidhje me to.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit nr. 101, datë 23.6.2016, si më poshtë:

a) Zëvendësimin kudo në kontratën tip, të termit “Kodi i Shpërndarjes” me termin “Kodi i Transmetimit”;

b) Në paragrafët hyrës të kontratës, të përcaktohet çmimi aktual për shitjen e energjisë elektrike nga HEC-i Lengaricë;

c) Në nenin 1, “Kontrata” shtohet “me konsensusin e të dyja palëve” në fund të paragrafit;

d) Në nenin 1, “Ligji” të hiqet “ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligji 138/2013”;

e) Në nenin 1 “Pikë livrimi” të bëhet “Për efekt të kësaj kontrate pika e livrimit do të jetë vendi i përcaktuar nga OST-ja për të bërë matjen e energjisë elektrike, objekt i kësaj kontrate”;

f) Në nenin 5, të shtohet paragrafi “Në çdo rast blerësi dhe shitësi do të trajtojnë disbalancat e krijuara, nëse ka, sipas parashikimeve të nenit 14, pika 7, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”;

g) Pika 3 e nenit 5, bëhet pika 4 e nenit 5;

h) Pika 4 e nenit 5, bëhet pika 5 e nenit 5, me përmbajtje “Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga OSHEE sh.a., ndaj impianteve prodhues zbatohen Rregullat e Tregut mbi Disbalancat, sipas parashikimeve të nenit 99, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”;

i) Neni 6, pika 6.1, bëhet “Palët në këtë kontratë do të sigurojnë njëra-tjetrën se livrimet dhe pranimi i energjisë elektrike do të maten ose verifikohen me sistem matjeje në përputhje me procedurat dhe standardet e përcaktuara në Kodin e Transmetimit ose në Kodin e Funksionimit të Shpërndarjes, sipas mënyrës së lidhjes në rrjet, në kohën e ndërtimit të hidrocentralit dhe Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike;

j) Të hiqen pikat 6.6, 6.7 dhe 6.8, të nenit 6 dhe të futet neni 6.4 i kontratës së miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me përmbajtje”. Në ditën e caktuar nga palët në kontratë (ose në ditën e fundit të muajit përkatës), përfaqësuesit e autorizuar të shitësit dhe blerësit do të takohen për të lexuar aparatin matës të energjisë elektrike, që përcakton sasinë mujore të energjisë së livruar nga shitësi te blerësi çdo muaji. Tregimi i numërorit të matësit do të lexohet dhe do të regjistrohet çdo muaj për të realizuar kryerjen e bilancit të shitblerjes së energjisë elektrike. Në rast të mosfunksionimit të sistemit të matjes, për shkak të defekteve, marrja e të dhënave do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve, duke iu referuar regjistrave të leximit të matjes”;

k) Në nenin 6, në pikat 6.6 deri 6.8, të parashikohet një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm për subjektet e lidhura me rrjetin e transmetimit;

l) Të ndryshojë përmbajtja e nenit 7 “Sipas një kërkesë të arsyeshme, palët: a) do t’i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë, i cili evidenton sasitë, livrimet dhe pranimet e energjisë elektrike, për qëllimet e përcaktimit të masës dhe shkakut të çdo devijimi nga programet; b) do të kërkojnë nga operatori i sistemit të shpërndarjes dhe do të ndajnë mes tyre çdo dokumentacion



shtesë të nevojshëm për të verifikuar mospërputhjet mes flukseve të programuara dhe reale të energjisë elektrike;

m) Në nenin 8, pika 2, të bëhet pagesa; blerësi do t'i kryejë pagesën shitësit kundrejt vlerës së faturës mujore. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të faturës nga blerësi. Data e pagesës do të konsiderohet data kur kjo pagesë do të transferohet efektivisht në llogarinë bankare të shitësit;

n) Të shtohet pika 8.5 me përmbajtje “Palët pranojnë se fatura që lëshon shitësi për blerësin në kuptim të këtij neni përbën titull ekzekutiv”;

o) Neni 11 të bëhet “Blerësi paguan shitësin për energjinë elektrike të blerë, me çmimin e llogaritur dhe të miratuar, nga ERE sipas legjislacionit në fuqi. Çmimi i aplikueshëm në momentin e lidhjes së kësaj kontrate është çmimi në fuqi i llogaritur dhe miratuar nga ERE. Për qartësi, si rregull ERE llogarit dhe miraton me vendim brenda vitit paraardhës, çmimin e shitjes së energjisë për vitin pasardhës. Nëse çmimi vjetor del më vonë se fillimi i vitit pasardhës, ky çmim do të ketë fuqi vepruese që nga data 1 janar e vitit pasardhës dhe palët do të bëjnë korrigjimet e nevojshme për sasitë e faturuara para hyrjes në fuqi të çmimit të periudhës pasardhëse, në përputhje me vendimin përkatës të ERE-s;

p) Në nenin 13, pika 2, të korrigjohet referenca nga neni 9 (faturimi dhe pagesa), në nenin 8 (faturimi dhe pagesa);

q) Në nenin 14, të shtohet pika 9, me përmbajtje “Duke pasur parasysh modelin tranzitor të tregut të energjisë elektrike sipas parashikimeve të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, në rast se zgjidhja e kësaj kontrate do të kryhet si rrjedhojë e një akti normativ të ERE-s, në kuadër të zbatimit të rregullave të reja të tregut të energjisë elektrike dhe jo nga vullneti i secilës palë, pala që mund të kërkojë zgjidhjen është e detyruar të njoftojë palën tjetër të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara përfundimit të kontratës. Në një rast të tillë palët do të zbatojnë parashikimet e pikës 8 të këtij neni për likuidimin e detyrimeve financiare midis tyre”;

r) Neni 15, pika 1, të bëhet “Kjo kontratë do të jetë në fuqi për një periudhë 15-vjeçare (pesëmbëdhjetëvjeçare) ose deri në datën _____. (për subjektet që kanë një kontratë të shitblerjes së energjisë elektrike me KESH sh.a. para apo në kohën e hyrjes në fuqi të vendimit

nr. 101, datë 23.6.2016 të ERE-s, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me OSHEE sh.a. do të lidhet për periudhën e mbetur nga përfundimi i kontratës së lidhur);

s) Në nenin 15, të shtohet pika 2 me përmbajtje “Duke qenë se shitësi ka një kontratë të shitblerjes së energjisë elektrike me KESH sh.a. para apo në kohën e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 101, datë 23.6.2016 të ERE-s, blerësi garanton se shitësi do të vazhdojë të gëzojë të drejtat e parashikuara në kontratën e mëparshme me KESH sh.a. për gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate. Kjo kontratë përbën marrëveshjen finale të Palëve si rrjedhojë e zbatimit të vendimit nr. 101, datë 23.6.2016 të ERE-s, nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, nëpërmjet transferimit të kontratës datë____, lidhur midis shitësit dhe shoqërisë KESH sh.a., e cila rregullohej, përveç të tjerave, edhe nga ligji nr. 9072, datë 22.5.2003, për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 133, datë 15.8.2016

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2016 PËR SHOQËRINË “KESH” SHA

Në mbështetje të nenit 16; nenit 107, pika 1, germa “g”; nenit 109, pika 5; nenit 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; gjithashtu, dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016;



rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009, nenet 7, pika 2; neni 8 dhe neni 11; neni 12; neni 13; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.8.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për miratimin e planit të investimeve për vitin 2016 për shoqërinë “KESH” sh.a., të përgatitur nga drejtoritë teknike,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Planit të investimeve për vitin 2016”, të shoqërisë “KESH” sh.a., për investimet me fondet e huaja sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të miratojë për vitin 2016 kryerjen e investimeve me fondet e veta nga shoqëria KESH sh.a., në vlerën 3 (tre) miliardë lekë.

3. Shoqëria “KESH” sh.a., të paraqesë për miratim në ERE, planin e investimeve për vitin 2016, që shoqëria do të realizojë me fondet e veta siç është përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë KESH sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

Investimet e Parashikuara të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare për vitin 2016 (000 lekë)									
Emërtimi i investimit	Njësia	Viti 2016				Viti 2016	Qellimi i Realizimit të Investimit		
		3M-I	3M-II	3M-III	3M-IV		Rritje e efijencës së prodhimit	Rritja e sigurisë së veprave	Përmirësimi i kushteve të punës në HEC-e
Masat mbrojtëse të anës së majtë të Bjeftit të Poshtëm përballë Tuneleve nr.3 dhe nr.4 nga ura e rrymëshpejtuesit deri tek muri ekzistues tek Ura e Drinit	HEC Fierzë	5	100,000	150,000	150,000	400,000		X	X
Sistemimi i sheshit tek magazinë e re, kthimi i këtij sheshi në parking automjesh të mbuluar	HEC Fierzë	21,000				21,000			X
Prita malore dhe punime mirëmbajtje në pritak ekzistuese tek përrrenjet e Mark Ndreu dhe Gropaj etj. Evadim i materialeve të ngurta tek baseni sipër rrymëshpejtuesit, sistemim i zonës nga rrymëshpejtuesi tek rruga hyrëse në hidrcentral dhe ndërtimi i kanalit të ujrave kulluese.	HEC Fierzë			49,100		49,100	X	X	
Rehabilitimi i zonave të demtuara nga fenomeni i kavitacionit tek tuneli nr.4 i shkarkimit	HEC Fierzë		60,000			60,000		X	
Instalimi i piezometrave dhe inklinometrave në shpatet e digës dhe furnizim-vendosje e 4 kapërderdhsave	HEC Fierzë		15,000			15,000		X	X
Blerje elektropompe për impijantin hidraulik në veprën e marjes	HEC Fierzë	25,000				25,000		X	X
Gjenerator saldimi për punime në rrotën e punës (I=700A)	HEC Fierzë		2,000			2,000			X
Riparimi i rrjedhjeve të materialit bituminoz tek agregati nr.2 dhe zëvendësimit i tij.	HEC Fierzë		12,000			12,000		X	
Pastrimi i zonës para rrjetave (kuota 222m) dhe rrjetave të punës tek seksionet e tubacionit të agregatit nr. 4 me konsulencë të huaj, për zëvendësimin e rrjetave të punës. (niveli i liqenit duhet të jetë poshtë kuotës 270m).	HEC Fierzë				300,000	300,000	X	X	
Rikonstruksioni i shkalleve nga ndërtesa e centralit deri tek N/Stacioni 220 kV dhe i shkallëve nga ndërtesa e centralit deri tek kurora e digës.	HEC Fierzë	15,200				15,200		X	X
Betonim i pusit të shuarjes dhe rrymëshpejtuesit.	HEC Fierzë			60,000		60,000		X	
Rehabilitimi i kanalit të ujrave të larta poshtë N/Stacionit 220 kV	HEC Fierzë			12,000		12,000		X	



Blerje paisje për pastrimin e sallave të ndërtesës së centralit	HEC Fierzë		1,500			1,500		X	X
Blerje automjet tip ure për kontrollin dhe mirëmbajtjen rutinë të makinave	HEC Fierzë		10,000			10,000	X		X
Rehabilitim i sistemit të ndriçimit të galerive të HEC duke instaluar sistem të ri me tension 36V			4,100			4,100		X	X
Blerje e paisjeve të sigurimit teknik dhe garderobave për punonjësit	HEC Fierzë	5,000				5,000		X	X
Rikonstruksion i objektit të karburantit (FV distributor dhe çisternë si dhe futja e çisternës nën tokë dhe tenda)	HEC Fierzë	3,500				3,500		X	X
Furnizim vendosje motorgenerator emergjencë diesel 1000 kVA, për nevojat vetjake të centralit.	HEC Fierzë	40,000				40,000		X	
Furnizim, vendosje 3 (tre) copë transformatorë fuqie 320 kV kVA, 10/0.4 kV për nevojat vetjake në Veprën e Marrjes dhe Tunelet e Shkarkimit	HEC Fierzë		7,500			7,500	X	X	
Furnizim vendosje transformator fuqie 400 kVA për furnizimin e impjantit të kondicionimit të sallave të ndërtesës së centralit dhe ndërtim i kabinës së tij.	HEC Fierzë		3,500			3,500	X		
Furnizim vendosje e portës kryesore të sheshit të montimit	HEC Fierzë		1,540			1,540		X	
Lyerje e vinçave të Sallës së Makinave dhe vinçit të Bjefit të Poshtëm	HEC Fierzë		1,900			1,900		X	
Furnizim vendosje pompa për galërinë e digës dhe pompa zhytëse për pusët e saraçineskave Ø500	HEC Fierzë			1,650		1,650		X	
Blerje analizator automatik peshtjellash për matje rezistence ohmike dhe koeficient transformimi	HEC Fierzë			9,000		9,000		X	
Sistemi i aspirimit tek reparti mekanik	HEC Fierzë			4,400		4,400			X
Pjesë rezervë për pajisjet elektrike dhe mekanike	HEC Fierzë			55,000		55,000	X	X	
Totali i Investimeve HEC Fierzë		109,700	219,040	341,150	450,000	1,119,890			
Rehabilitim i rrethimit të centralit, asfaltim i rrugës së makinave - postblloku dhe rikonstruksion i rrugës kryesore postbllok - godina qendrore të HEC	HEC Koman				55,000	55,000		X	X
Mbrojtje me blloqe betone e krahut perëndimor të daljes së tunelit nr.4 të shkarkimit dhe ndërtimi i digës mbrojtëse (pritës së përroit në krahun e majtë të rrjedhës së lumit)	HEC Koman		100,000	100,000	150,000	350,000		X	
Punime mbrojtëse të kanalit të daljes nga ndërtesa centralit, veshje me beton i fageve anësore	HEC Koman				100,000	100,000		X	
Heqja e materialeve inerte/drusore H 142m dhe pastrimi rrjetave tek tunelet e turbinave në veprën e marrjes	HEC Koman				280,000	280,000	X	X	
Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe digës (masivi shkëmbor i carë)	HEC Koman				125,000	125,000		X	
Blerje/vendosje të impjanteve shpërndarës 0.4 kV të paneleve të nevojave vetjake (2AG në 2016 dhe 2 AG në 2017)	HEC Koman				50,000	50,000	X	X	
Furnizim vendosje dy kompresor të presionit të lartë të ajrit	HEC Koman			35,000		35,000	X	X	



FV cele e kompletuar me celës 3 fazor 6 kV me gaz për impjantin 6 kV me gaz 630A tek impjanti 13 LGA	HEC Koman				30,000	30,000	X	X	
Ndërtimi i godinës së re të administratës së HEC Koman (përfshirë mobilimin)	HEC Koman				70,000	70,000			X
Ndërtimi dhe instalimi i një stacioni për monitorimin e infiltrimeve në digën e Komanit	HEC Koman		15,000			15,000			X
Monitorimi me kamera ROV i ekranit beton-arme të digës së Komanit	HEC Koman			10,000		10,000		X	
Instalimi i rrjetës metalike në urën e Dushajve për grumbullimin e mbetjet notuese urbane dhe mbrojtjen e liqenit	HEC Koman		10,000			10,000		X	
Konfigurimi e integrimi i setit on-line BMT me sensor të ri tek transformatori TR1 170 MVA ne sistemin DGA-BMT	HEC Koman		5,500			5,500		X	
Pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtje në central	HEC Koman		55,000			55,000	X	X	
Totali i Investimeve HEC Koman		0	185,500	145,000	860,000	1,190,500			
Pajisje dhe pjesë këmbimi për remontet dhe mirëmbajtjen e agregatëve.	HEC V. Dejë		50,000			50,000	X	X	
Rehabilitim i digës së Ragamit	HEC V. Dejë			100,000	150,000	250,000		X	
Rehabilitimi i sistemit të pompave dhe aksesorëve tek IVP e agregatëve. Tipi ly 5.8 P=25 bar ,Q= 5.8 l/sek N=28 KW n rrot =2940 rrot/min	HEC V. Dejë		45,000			45,000	X	X	
Riasfaltim me shtresë veshjeje asfalto-betoni i rrugës hyrëse HEC, rikonstruksion i sheshit, trotuareve dhe ndricimi i saj dhe mbrojtja e anës së majtë të kanalit të daljes	HEC V. Dejë				90,000	90,000		X	X
Rehabilitimi shoqëruar me rritje kapaciteti të HEC Theth (punime elektromekanike dhe hidroçivile)	HEC V. Dejë			20,000	20,000	40,000			
Rehabilitimi i galerive të drenazheve dhe të thëllësive brenda ndërtesës së centralit, sistem ndricimi, shkallë etc	HEC V. Dejë			17,000		17,000			
Instalim i sistemit të ngrohje-kondicionimit dhe mobilim i zyrave të administratës	HEC V. Dejë			12,000		12,000			
Rehabilitimi i vincit 100 ton vepra e marrjes	HEC V. Dejë		35,000			35,000		X	
Rikonstruksion i kushinetave mbështetëse duke instaluar impiantet e injektimit dhe qarkullimit.	HEC V. Dejë				200,000	200,000	X	X	
Rehabilitim i Gjeneratorit të Ag 2 (prodhim të ri të statorit komplet nukel+pështjella dhe me prodhim të ri të pështjellave të poleve të rrotorit)	HEC V. Dejë				400,000	400,000	X	X	
Betonim i daljes së tunelit të shkarkimit Zadejë dhe sistemimi i zonës përreth	HEC V. Dejë			26,000		26,000		X	
Rikonstruksion i sallës së komandës	HEC V. Dejë			20,000		20,000			X
Rikonstruksione i ambjentëve të jashtme	HEC V. Dejë			25,000		25,000			X
Rinovim i sistemit të mbrojtjes së agregatit me instalimin/konfigurimin e releve të reja	HEC V. Dejë		40,000			40,000	X	X	
Ndërtim kabine dhe FV transformator fuqie 630 kVA për furnizimin e HVAC të sallave të ndërtesës së	HEC V. Dejë		4,500			4,500		X	



centralit									
Rikonstrukcion vinci për bjefin e poshtëm 2X8 ton	HEC V. Dejës		5,500			5,500		X	
Rehabilitimi i dy kompleteve të rrjetave në veprën e marrjes	HEC V. Dejës			5,500	3,000	8,500		X	
Zëvendësim i 5 kompleteve të pompave të pikimit të vajit me rezervuarët përkatës në sallën e makinerive	HEC V. Dejës			5,000		5,000		X	
Rehabilitim i AG3 dhe AG4 me vendosje sisteme të reja eksitimi statik dixhital	HEC V. Dejës	230,000				230,000	X	X	
Furnizim dhe vendosje transformator fuqie 60MVA 220 kV	HEC V. Dejës	95,000				95,000	X	X	
Totali investimeve HEC Vau Dejës		325,000	180,000	230,500	863,000	1,598,500			
Totali investimeve për KESH Gjenerimin		434,700	584,540	716,650	2,173,000	3,908,890			
Panel Eksperti			3,534		3,534	7,067		X	
Konsulencë për implementimin e Projektit		16,760	16,760	16,760	16,760	67,042		X	
Menaxhimi financiar				16,760	16,760	33,521	X	X	
Studimi i fizibilitetit për të ofruar një menaxhim të sigurt të përmbytjeve në HEC e kaskadës së lumit Drin		62,013	62,013	62,013	62,013	248,054		X	
Totali i Investimeve Kredia e Bankës Botërore (IDA 4480-ALB)		78,774	82,308	95,534	99,068	355,684			
E-M Koman		393,869	393,869	393,869	393,869	1,575,478		X	
Totali i Investimeve Kredia IBRD 8111-AL		393,869	393,869	393,869	393,869	1,575,478			
Shkarkuesit HEC Koman					108,943	108,943		X	
Fundi i digës së HEC Koman dhe konsolidimi i bjeftit të poshtëm		113,133	113,133			226,265		X	
Totali i Investimeve Kredia EBRD 43125		113,133	113,133	0	108,943	335,208			
Projekti për sigurinë dhe monitorimin e digave - Faza III		15,352	15,352	15,352	15,352	61,406		X	
Totali i Investimeve nga SECO		15,352	15,352	15,352	15,352	61,406			
Shërbim konsulence				28,493	15,084	43,577		X	
Totali i Investimeve nga KFW		0	0	28,493	15,084	43,577			
Total i Investimeve Programi i Sigurisë së Digave		601,128	604,661	533,248	632,316	2,371,353			
Rikonstrukcion i Godinave të KESH dhe sistemim i ambienteve ndihmëse të tyre	KESH Qendër	140,000				140,000			X
Blerje automjetesh (KESH Qendër + Njësi Prodhimi)	KESH Qendër		35,000			35,000			X
Modelimi dhe renderizimi 3D i veprave gjeneruese të KESH	KESH Qendër				30,000	30,000			X
Rinovim i licensave ekzistuese, suportit dhe blerje licensash të reja dhe për pajisjet dhe software e KESH sh.a për sistemet IT të instaluar	KESH Qendër				17,500	17,500			X
Platforme GIS për asetet e KESH sh.a.	KESH Qendër			10,000		10,000	X		X
Krijim dhe mirëmbajtje e infrastruktures për komunikimin në kohë reale me KESH Qendër dhe Njësitë të Prodhimit (hardware, software, medium për telekomunikim dhe shkëmbim të dhënave mbi shfrytëzimin e kaskadës, monitorimin të blloqeve gjenerator-	KESH Qendër		40,000		50,000	90,000	X	X	



transformatorve, monitorimin gjeotezik të digave, etj.)									
Studime dhe vlerësime për ndërhyrjet/përmirësimet elektro-mekainke dhe sistemet e kontroll monitorimit në Njësitë e Prodhimit	KESH Qendër	60,000	50,000	20,000		130,000	X	X	X
Projekte, mbikqyrje, kolaudime dhe supervizime për ndërhyrjet hidroteknike në Njësitë e Prodhimit	KESH Qendër	50,000	30,000	20,000		100,000	X	X	X
Riparimi i impiantit të ftohjes së TEC Vlorës (zbatim dhe mbikqyrje)	KESH Qendër				200,000	200,000	X		
Ngritja e sistemit të monitorimit hidrologjik (reshje, prurje, nivele) në Kaskadën e Drinit	KESH Qendër		20,000			20,000	X	X	X
Blerje dy mjete lundruese për monitorimin e basenit të Bjefit të Sipërm të HEC Fierzë dhe të HEC Vau Dejës	KESH Qendër	25,000				25,000		X	X
Rehabilitimi i sistemit CMS për Njësitë e Prodhimit	KESH Qendër		160,000			160,000		X	
Blerje pajisje portative digitale për diagnostikimin e gjendjes së transformatorëve të fuqisë dhe celsave TL	KESH Qendër		45,000			45,000		X	
Furnizim vendosje i sistemit të matejes (HW/SW) për cdo gjenerator	KESH Qendër		4,500			4,500		X	
Blerje makinerie e posacme për pastrimin e mbetjeve notuese në liqenet e HEC Fierzë, Koman dhe Vau Dejës	KESH Qendër		20,000			20,000	X	X	
Digitalizim i arkivës teknike dhe shkresore të Njërive të Prodhimit dhe lidhja me arkivën qendrore	KESH Qendër			45,000		45,000			X
Totali i Investime KESH Qendër, përfshirë TEC Vlorë		275,000	404,500	95,000	297,500	1,072,000			
TOTALI INVESTIMEVE KESH Grup		1,310,828	1,593,701	1,344,898	3,102,816	7,352,243			

18

22

18

42

100

VENDIM**Nr. 134, datë 15.8.2016****PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2016 PËR SHOQËRINË “OST” SHA**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, germa “a” dhe “e”; nenit 60, pikat 4 dhe 5; nenit 107, pika 1, germa “g”; nenit 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s; rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009, të Bordit të ERE-s, nenet 7, pika 2; neni 9 dhe neni 11; neni 12; neni 13; Bordi i Entit Rregullator të

